



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Viti 2020



I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për vitin 2020, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP-www.akep.al, në seksionin “Statistika”.

Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare, duke përfshirë të dhënat më të fundit të disponueshme të tregut.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për vitin 2020 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (25 subjekte):**

1. DHL International (Albania) sh.p.k;
2. T.N.T Express Albania sh.p.k;
3. Albanian Cargo Service sh.p.k;
4. United Transport sh.p.k;
5. Albanian Delivery Express sh.p.k;
6. Ulysses Enterprises (Fedex) sh.p.k;
7. Youth Albania Professional Services sh.p.k;
8. E-Komplet sh.p.k;
9. COEX sh.p.k;
10. Albanian Parcel Distribution sh.p.k;
11. Speed Couriers Albania sh.p.k;
12. Intex Courier sh.p.k;
13. Turboo Albania sh.p.k;
14. Panorama Group sh.a;
15. Flash Delivery Albania sh.p.k;
16. Balkan Courier & Logistics sh.p.k;
17. I V Y sh.p.k;
18. ALOPOST sh.p.k;
19. Prime Express sh.p.k;
20. ALL IN ONE COOL sh.p.k;

21. Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k;
22. Fast Delivery sh.p.k;
23. Mr. Courier sh.p.k;
24. Top Post sh.p.k;
25. HDC Express sh.p.k;

AKEP, për subjektet e listuara sa më sipër:

- Në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.13, datë 30.06.2020 ka pajisur Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.
- Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 38, datë 19/11/2015, “Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, subjektet e sipërcituar janë pajisur nga AKEP me Certifikatë të Konfirmimit të Njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit dhe evidenca e realizimit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimeve ekspres/jo universale;
4. Treguesit teknik dhe të rrjetit;
5. Cilësia / Standardet e realizimit të shërbimeve postare;
6. Të punësuarit;
7. Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet);
8. Të ardhurat financiare nga shërbimet postare.

Posta Shqiptare, si ofruer i shërbimit universal postar ka plotësuar Formularin A me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga pika A deri në pikën H, ndërsa ofruerit e tjerë të shërbimeve postare kanë plotësuar Formularin C me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga A deri në pikën G.

IV. TRAJTIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

Të dhënat e dërguara dhe të trajtuara në këtë raport jepen për zërat kryesorë të shërbimeve postare, në të cilat përfshihen nën-zërat e tyre.

Paraqitja e të dhënave është bërë në mënyrë tabelore dhe grafike duke ju referuar të dhënave për objektet postare të pranura si dhe krahasimi me vitet e paraardhëse.

1. Të dhëna përmbledhëse të shërbimeve postare

Tregu i ofrimit të shërbimeve postare përgjatë vitit 2020 është impaktuar në mënyrë të ndjeshme nga efektet e pandemisë, duke diktuar tkurrje të volumeve të përpunuara kryesisht atyre ndërkombëtare. Shërbimi postar Universal dhe ai Ekspres të ofruara nga PSH rezultojnë me rënie të konsiderueshme të volumeve, si për postën brenda vendit ashtu edhe atë ndërkombëtare,

e kundërta ka ndodhur me shërbimin jo-universal postar i cili ka shënuar rritje për shërbimin postar brenda vendit.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2020 nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 24.7 milionë.

Numri i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare gjatë vitit 2020 ka pësuar rënie me 4%, gjithashtu numri i përgjithshëm i objekteve të pranuar nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ka pësuar një rënie me rreth 4% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 1.1- Të dhëna mbi kategoritë kryesore të objekteve postare (2019-2020)¹

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2019	Objekte postare 2020	Ndryshim 2020/2019
Posta Shqiptare sh.a				
1	Shërbim Universal Postar			
1.1	Postë brenda vendit	20,348,070	17,487,538	-14.1%
1.2	Postë ndërkombëtare	1,152,935	903,336	-21.6%
1.3	Totali 1.1+1.2	21,501,005	18,390,874	-14.5%
2	Shërbim jonivrsal postar			
2.1	Postë brenda vendit	656,177	873,512	33.1%
2.2	Postë ndërkombëtare	5,624	2,344	-58.3%
2.3	Totali 2.1+2.2	661,801	875,856	32.3%
3	Shërbim ekspres			
3.1	Ekspres brenda vendit	644,049	486,531	-24.5%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	79,071	12,874	-83.7%
3.3	Totali 3.1+3.2	723,120	499,405	-30.9%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4.1	Postë brenda vendit	698,388	1,914,761	174.2%
4.2	Postë ndërkombëtare	39,769	45,036	13.2%
4.3	Totali 4.1+4.2	738,157	1,959,797	165.5%
5	Shërbim ekspres			
5.1	Ekspres brenda vendit	2,010,034	2,796,387	39.1%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	246,931	272,860	10.5%
5.3	Totali 5.1+5.2	2,256,965	3,069,247	36.0%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	25,881,048	24,795,179	-4.2%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

E kundërta ka ndodhur me volumet e pranuar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare të cilat përgjatë vitit 2020 kanë shënuar rritje për të gjithë treguesit e shërbimit jo-universal dhe atij ekspres. Rritjen më të madhe e ka shënuar shërbimi jo-universal postar për postën brenda vendit me rreth 174%, ndërkohë edhe shërbimi postar ekspres brenda vendit ka shënuar rritje me rreth 39% krahasuar me vitin 2019. Rritje ka shënuar edhe posta ndërkombëtare, por kjo rritje ka qenë në nivele më të ulëta rreth 10-13%.

¹ Të dhënat e vitit 2019 për P.SH janë përditësuar sipas shkresës me Nr.416 prot, datë 23.02.2021 dërguar nga Posta Shqiptare

Efektet e mbylljes si shkak i pandemisë kryesisht gjatë tremujorit të dytë 2020, kanë bërë që ofruesit e shërbimeve tregtare, si edhe ato financiare të zhvendosen nga metodat e prezencës fizike në dyqane drejt kryerjes dhe marrjes së këtyre shërbimeve online dhe me korrier (postë). Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2020, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, për ofrimin e shërbimeve postare në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:


- Objekte postare gjithsej 24,795,179 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2,845,955² janë: 8.71 objekte / banorë.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me popullsinë 2,845,955 janë: 3,103 banorë / zyrë.
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me sipërfaqen 28,748 Km² janë: 31.35 Km² / zyrë.

2. Treguesit dhe evidenca e realizimit të Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Posta Shqiptare bazuar në Autorizim Individual të lëshuar nga AKEP gëzon të drejtën si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar deri në vitin 2025. Volumin kryesor në shërbimin universal postar brenda vendit e zënë ‘Objektet e thjeshta’ me 15,115,779 copë ose 86% të ndjekura nga ‘Objektet e regjistruara’ me 2,371,759 copë ose rreth 14% të këtij treguesi.

Në grafikët 2.1 dhe 2.2 të paraqitur më poshtë, jepen të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimit universal postar brenda vendit të pranuar nga *Ofruesi i Shërbimit Universal* gjatë vitit 2020, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve në raport me vitet paraardhëse.


Grafiku 2.1: Treguesit e Shërbimit Universal brenda vendit për vitin 2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

² Popullsia 1 janar 2020, INSTAT


Grafiku 2.2: SH.U brenda vendit- Ecuria në vite (numër objektsh)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.2 vihet re se në vitin 2020 ka një rënie prej 14% të numrit të objekteve postare brenda vendit krahasuar me 2019.


Grafiku 2.3: SH.U. - Postë ndërkombëtare (numër objektsh përgjatë vitit 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.3 vihet re se volumin kryesor në shërbimin universal postar ndërkombëtar për Objektet Postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë ‘Objektet e regjistruara’ me 156,324 copë ose 77% të ndjekura nga ‘Objektet e thjeshta’ me 46,499 copë ose 23%, ndërsa në ‘Objekte hyrëse’ nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Objektet e regjistruara me 417,296 copë ose 60% të ndjekura nga ‘Objektet e thjeshta’ me 283,217 copë ose 40%.

Grafiku 2.4: Treguesi i SH.U për Postë ndërkombëtare 2015 - 2020




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 2.4 vihet re se gjate vitit 2020 Posta Shqiptare ka realizuar gjithsej 903,336 objekte postare të pranura në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe ‘Objekte hyrëse’ nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri, gjithashtu evidentohet se Posta ndërkombëtare e përpunuar nga ofruesi i Shërbimit Universal ka pasur një rënie të ndjeshme me rreth 22% gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019.

3. Treguesit e shërbimit jo-universal postar


Grafiku 3.1: Shërbimi jo-universal i Postës Shqiptare brenda vendit gjatë vitit 2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.1 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar brenda vendit për Postën Shqiptare e zënë Objektet e regjistruara me 798,290 copë ose 91% të ndjekura nga Objektet e tjera me 75,222 copë ose 9%.


Grafiku 3.2: Shërbimi jo-universal brenda vendit nga Operatorët e tjerë postarë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Operatorët e tjerë postarë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.2 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar brenda vendit për Operatorët e tjerë postar e zënë ‘Objektet e thjeshta’ me 1,102,131 copë ose 58% të ndjekura nga “Të tjera” me 596,296 ose 31% dhe ‘Jo dokumente Pako/Koli’ me 200,761 copë ose 10%.


Grafiku 3.3: Shërbimi jo-universal postar brenda vendit -P.SH / Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga grafiku 3.3 vihet re se Posta shqiptare mbulon 31% të shërbimit jo-universal postar brenda vendit me 873,512 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 69% me 1,914,761 objekte.


Grafiku 3.4: Shërbimi jo-universal postar ndërkombëtar – Posta Shqiptare (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.4 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Postën Shqiptare për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e regjistruara me 1,000 copë ose 79% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 267 copë ose 21% , ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri volumin kryesor e zënë Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta me 1,077 copë ose 100%.


Grafiku 3.5: Shërbimi jo-universal postar ndërkombëtar – Operatorët e tjerë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 3.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Operatorët e tjerë postar për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e korrespondencës me 11,350 copë ose 60% të ndjekura nga Jo dokumente Pako/Koli me 7,668 copë ose 40%, ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Jo Dokumente Pako/Koli me 14,152 copë ose 54% të ndjekura nga Objektet e korrespondencës me 11,866 copë ose 46%.


Grafiku 3.6: Shërbim jo-universal postar ndërkombëtar - P.SH / Ofruesit e tjerë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga grafiku 3.6 vihet re se Posta shqiptare mbulon 5% të shërbimit jo-universal postar ndërkombëtar me 2,334 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 95% me 45,036 objekte.

Grafiku 3.7: Shërbimi jo-universal postar - P.SH / Ofruesit e tjerë




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe operatorët e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga grafiku 3.7 vihet re se Posta shqiptare mbulon 31% të shërbimit jo-universal postar (kombëtar dhe ndërkombëtar) me 875,856 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 69% me 1,959,797 objekte.

4. Treguesit e shërbimit Ekspres

“Shërbimi ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, në një kohë të shkurtër, shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave.


Grafiku 4.1: Shërbimi ekspres – Posta Shqiptare (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.1 vihet re se 98% e shërbimit ekspres brenda vendit mbulohet nga Dokumente ndërsa në shërbimin ekspres ndërkombëtar 84% e shërbimit mbulohet nga objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 16% nga objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.


Grafiku 4.2: Shërbimi ekspres brenda vendit / ndërkombëtar - Posta Shqiptare (viti2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.2 vihet re se për Postën Shqiptare 97% e shërbimit ekspres mbulohet nga shërbimi ekspres brenda vendit dhe vetëm 3% nga shërbimi ekspres ndërkombëtar.

Grafiku 4.3: Shërbimi ekspres në total – Posta Shqiptare – Ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.3 vihet re se për Postën Shqiptare gjatë vitit 2020 shërbimi ekspres në total (brenda vendit dhe ndërkombëtar) ka pësuar rënie me rreth 30% në krahasim me vitin e shkuar.

Në vijim jepen në formë tabelore dhe grafike të dhënat statistikore për Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimet ekspres, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e tyre.

Tabela 4.4: Shërbimi ekspres për Ofruesit e Tjerë (viti 2020)


	Totali	Albanian Delivery Express	DHL	TNT	FEDEX	United Transport	YAPS	Albanian Parcel Distribution	INTEX COURIER sh.p.k	TURBOO ALBANIA sh.p.k	PRIME EXPRESS sh.p.k.	Mr. COURIER sh.p.k.
Ekspres brenda vendit	2,796,387	1,893,048	10,814	130,700	0	591,293	44,812	40,730	38,185	18,126	10,788	17,891
Ekspres ndërkombëtar	272,860	5,507	164,739	1,133	39,656	61,825	0	0	0	0	0	0

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Referuar tabelës 4.4 rezulton se për ofruesit e shërbimeve postare ekspres brenda vendit treguesit më të mirë për objektet e pranuar i ka Albanian Delivery Express me 1,893,048


objekte. Për sa i përket objekteve ekspres ndërkombëtare treguesit më të mirë i ka DHL me 164,739 objekte.

Grafiku 4.5: Shërbimi ekspres për Ofruesit e Tjerë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP


Grafiku 4.6: Shërbimi ekspres për Ofruesit e Tjerë (viti 2020) – brenda vendit/ndërkombëtar



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Në grafikët e mësipërm është paraqitur mbulimi i tregut postar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare të ndara në ekspres brenda vendit dhe ekspres ndërkombëtar.


Grafiku 4.7: Numri total i objekteve postare për Ofruesit e Tjerë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP


Nga të dhënat e grafikut 4.7 rezulton se gjatë vitit 2020 ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar 3,069,247 objekte postare që i përkasin shërbimit ekspres ose 61% dhe 1,959,797 objekte postare që i përkasin shërbimit jo-universal ose 39%.

Grafiku 4.8: Shërbimi postar ekspres – P.SH/Ofruesit e tjerë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP


Grafiku 4.9: Shërbimi postar ekspres – P.SH/Ofruesit e tjerë (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikëve 4.8 dhe 4.9, duke krahasuar shërbimin ekspres në total të Postës Shqiptare dhe Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare rezulton se Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 86% të tregut ekspres me 3,069,247 objekte postare dhe Posta Shqiptare 14% me 499,405 objekte postare.,


Grafiku 4.10: Numri total i objekteve postare – P.SH/Ofruesit e tjerë(viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.10 vihet re se gjatë vitit 2020 Posta Shqiptare ka realizuar 19,766,135 objekte postare në total ose 80% kundrejt 5,029,044 objekte postare në total për gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në total ose 20%.

Grafiku 4.11: Numri total i objekteve postare – P.SH + Ofruesit e tjerë – Ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 4.11 vihet re se gjatë vitit 2020 ka pasur një rënie prej 1,085,869 objekte postare ose 4.2 % krahasuar me vitin 2019.

5. Treguesit teknik të rrjetit postar


Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **561** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga United Transport, Albanian Cargo Service, Albanian Delivery Express, TNT etj.

Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal 700 sportele, nga të cilët 521 sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Për pranimin e objekteve postare ka venë ne dispozicion të përdoruesve 579 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 667 kuti postare, gjithsej 1,246 kuti postare.

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.

Grafiku 5.1: Treguesit teknik për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë (viti 2020)




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Siç vihet re edhe nga Grafiku 5.1, për sa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 438 mjete transporti, FEDEX 99, Albanian Delivery Express 77, United Transport 51, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

Në mjetet e transportit përfshihen kamionë, furgonë, vetura, motorë, motoçikleta dhe biçikleta.

Grafiku 5.2: Treguesit teknik të rrjetit – Posta Shqiptare/Ofruesit e tjerë (viti2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

6. Cilësia dhe standardet e shërbimit postar

Sipas nenit 33 te Ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” AKEP-i, me rregullore (Rregullorja Nr.36 Datë 29.10.2015), përcakton standardet për cilësinë e shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit me cilësi të mirë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Tabela 6.1:Cilësia dhe standardet e Shërbimit Universal Postar (viti 2020)

SHU - VITI 2020	Postë brenda vendit							Postë ndërkombëtare				
	Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra			Vendet e BE (Europë)			Vendet e tjera (UPU)	
	D+1	D+2	D+1	D+2	D+2	D+3	D+4	D+3	D+5	D>5	D+5	D>5
	95.0%	4.0%	94.0%	6.0%	80.0%	20.0%	0.0%	83.0%	95.0%			

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare. Përpunimi AKEP

Nga Tabela 6.1 vihet re se ofrimi i shërbimeve postare universale është realizuar në përputhje me standardet evropiane dhe ato botërore për shërbimet postare universale, të përcaktuara nga UPU-ja, si dhe me standardet e përcaktuara nga AKEP me rregullore.

Tabela 6.2: Cilësia dhe standardet e Shërbimit Postar – Ofruesit e tjerë (viti 2020)


	Postë brenda vendit			Postë ndërkombëtare		
	D+1	D+2	D>2	D+1	D+2	D>2
Albanian Delivery Exppress	90	7	3	85	10	5
DHL	98.1	1.9	0	94.9	4.1	0.01
TNT	50	10	40	44	26	30
FEDEX				54	46	0
United Transport	95	5	0	85	15	0
YAPS	79	0	21			
Albanian Parcel Distribution	100	0	0			
INTEX COURIER sh.p.k	95	5	0			
TURBOO ALBANIA sh.p.k						
PRIME EXPRESS sh.p.k.	100	0	0			
Mr. COURIER sh.p.k.	95	5	0			

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

7. Të punësuarit

Në funksion të volumit të punës Posta Shqiptare ka 2,461 të punësuar, United Transport 106, Albanian Delivery 100, Intex Courier 84, të ndjekur nga subjektet e tjerë sipas shifrave që paraqiten në grafikun e mëposhtëm


Grafiku 7.1: Numri i të punësuarave për të gjithë ofruesit e shërbimeve postare (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 7.1 duket qartë se Posta Shqiptare mbulon 78% të tregut postar të të punësuarve në total me 2461 persona kundrejt 22% të ofruesve të tjerë së bashku ose 692 persona.

Grafiku 7.2: Numri i të punësuarave – Ecuria në vite




Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 7.2 vihet re se tre vitet e fundit ka një rritje të lehtë të numrit të të punësuarve në sektorin postar, konkretisht në vitin 2020 ka pasur një rritje me 8%.

8. Ankesat

Sipas të dhënave të dërguara, gjatë vitit 2020 pranë Posta Shqiptare janë depozituar 1,742 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 1,742, pranë DHL janë depozituar 59 reklamacione të cilat janë zgjidhur plotësisht.

Grafiku 8.2: Numri i ankesave pranuar dhe të zgjidhura – Ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të pranuar, gjatë vitit 2020 vërehet një rritje me rreth 11% të ankesave për ofruesin e shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2019, gjithashtu nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të zgjidhura gjatë vitit 2020 vërehet se 100% e ankesave janë zgjidhur nga ofruesi i shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, ashtu si edhe në vitin 2019.

9. Rezultatet financiare³


Në zbatim të ligjit Nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” AKEP mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore.

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2020 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë **2,802 milionë** Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,489, milionë Lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 1,318 milionë Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve

³ Të ardhurat dhe investimet mund të ndryshojnë në varësi të raporteve të auditimit dhe raportimit në AKEP

të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2020. Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2020 janë rritur me rreth 18% në krahasim me vitin 2019.

Grafik 9.1 Pjesë tregu në të ardhurat e sektorit postar (viti 2020)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut 9.1 vihet re se Posta Shqiptare mbulon pjesën më të madhe të të ardhurave me rreth 53%, e ndjekur nga DHL me 26%, United Transport dhe Albanian Delivery Express me 7%. Operatorët e tjerë të gjithë së bashku mbulojnë rreth 7% të totalit të të ardhurave nga sektori postar.

Për sa i përket të ardhurave të Postës Shqiptare, rreth 86% e të ardhurave janë gjeneruar nga shërbimi universal postar, ndjekur nga shërbimi postar ekspres me 13 %.

Grafik 9.3 Ecuria e të ardhurave dhe investimeve 2012-2020 (në milionë lekë)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Ecuri pozitive kanë shënuar edhe investimet e kryera në sektorin postar, të cilat në fund të vitit 2020 raportohen mbi 363 milionë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë investimet e bëra nga Posta Shqiptare, me rreth 92% të totalit.